



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:226350
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05758619

CAP.nr.1731/23

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit të përmbarimit Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Farmaceutik, kundër debitores së përmbarimit E.G përgjegjës i subjektit juridik “,,,” - P,,, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, PPP.Nr.475/18, të datës 20.04.2020, me datën **27.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitores së përmbarimit E.G përgjegjës i subjektit juridik “,,,” - P,,, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, PPP.Nr.475/18, i datës 20.04.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.Nr.475/18, të datës 20.04.2020, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitores E.G përgjegjës i subjektit juridik ,, rr. ,, p.n P,,, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit numër P.nr.500/2017 datë 13.12.2017, të lejuar nga Zyra Përmbarimore e përmbaruesit A.M në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka paraqitur ankesë për shkak të *shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale*, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar dhe Urdhri për lejimin e përmbarimit numër P.Nr.500/2017 i datës 13.12.2017 të lejuar nga Zyra përmbarimore e Përmbaruesit Privat A.M në Prishtinë, duke pasur parasysh provat e bashkangjitura.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorës, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Farmaceutik me datën 13.12.2017, ka paraqitur propozim për përmbartim, ndaj debitorit E.G përgjegjës i subjektit juridik ,,,,, në bazë të Vendimit nr.,/,-,-,, të datës 04.05.2017. Përmbartuesi Privat A.M i emëruar në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka nxjerrë Urdhrit Përmbartimorë P.Nr.500/17, me të cilin ka caktuar përmbartimin.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim është theksuar se përmbartimi është i papërshtatshëm për ekzekutim dhe i paekzekutueshëm, sepse i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, konkretisht nenit 71. Po ashtu debitori konsideron se urdhri për lejimin e përmbartimit është i papërshtatshëm për ekzekutim sepse është në kundërshtim me nenin 24 lidhur me nenin 27 të LPP-së. Përgjigje në prapësim nuk ka paraqitur kreditori.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar PPP.Nr.475/18, të datës 20.04.2020, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se debitori nuk ka ofruar prova për të argumentuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se sipas aktvendimit nr. 10/MS-002-17 i datës 04.05.2017, në bazë të të cilit organi përmbartues ka zbatuar përmbartimin, është dokument përmbartues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 dhe 27 i I-PP për të qenë i përmbartueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbartim. Andaj, nga arsyet e paraqitura, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit e të cilat janë parapara në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruar nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar si të pabazuar duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të ankimuar. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të

LPK dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se Aktvendimi ti Ministrisë së Shëndetësisë është i plotfuqishëm me datën 02.08.2017 dhe i ekzekutueshëm me datë 11.08.2017, në rastin konkret është dokument përmbarues, kjo parashihet në nenin sipas nenit 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se “dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të LPP me rastin e refuzimit prapësimi, nuk qëndrojnë.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktojë dhe zbatojë përmbarimin. Nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se nuk ka pasur kushte ligjore që gjykata ta refuzoj ankesën e debitorit në tersi, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata në procedurë përmbarimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për lejimin e përmbarimit dhe në procedurën sipas prapësimi gjykata e shkallës së parë i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP.

Lidhur me pretendimin e debitorit se gjykata e shkallës së parë nuk e ka marr parasysh Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative me numër A.Nr.1021/17 të datës 11.01.2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses E.G, pronare e Barnatores ,, në P,, dhe ka anuluar vendimin Nr.10/R-99-17 të datës 06.02.2017 me numër të protokollit 05-3452/2 dhe datë 06.06.2017 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje dhe rishqyrtim të e paditura. Gjykata e Apelit pas analizimit dhe vlerësimit të vendimit të Gjykatës Themelore- Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1021/17 të datës 11.01.2021 gjeti se i njëjti vendim nuk është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm dhe se pala e pakënaqur ka pasur të drejtë të paraqes ankesë, me ç’rast si i tillë ky vendim nuk mundet ta humb fuqinë e titullit ekzekutiv të Aktvendimit nr.,/,-,-,,i datës 04.05.2017 në bazë të nenit 71 par. 1 pika 1.2, në këtë fazë të procedurës nuk mund të aprovohet ankesa e debitorit.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP, me të cilën është paraparë se “në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:226350
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05758619

CAP.nr.1731/23, me datën 27.05.2024

**Gjyqtari
Arsim Hamzaj**